

16.05.2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
VLORE

Nr.Regj.Them 1002
Dt.Regj 13.04.2016

Nr. 741 . Vendimi
Datë 16.05.2016

V E N D I M

“Në emër të Republikës”

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore, e përbërë prej :

Gjyqtar- Astrit Shema

Asistuar prej sekretares gjyqësore Anila Rista, në Vlore, sot më datë 16.05.2016 përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike çështjen civile me Nr. 1002. Regj.Them, date paraqitje 13.04.2016, që i përket palëve ndergjyqese :

Paditës : Elide Bombaj, e bija e Buhranit dhe e Llambes, e datëlindjes 07.05.1975, lindur dhe banuese ne Vlore Lagja “Pavarsia”, Rruga “Nairn Frarsheri”, Pallati Endri, kati i pare, Vlore.

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore, përfaqësuar me autorizim e datës 09.05. 2016. Nga juristja Orjada Myrtaj.(ne mungese)

Objekti: Shpalljen e pavlefshmërisë se pjesshme te Akt-Konstatimit 0215356, si edhe anulimin e gjobës prej 35.000 leke te reja vendosur nga ky institucion.

Baza ligjore: Nenet 153 e vijues te Kodit te Pre Civile, si edhe nenet 119, 120, te Kodit te Procedurës Civile.

Gjykata pasi mori provat e nevojshme, dëgjoji ne kërkimet përfundimtare palën paditëse ne proces e cila u shpreh : Për pranimin e padisë,
Përfaqësuesi i palës se paditur-Drejtoria Rajonale Tatimore ne kërkimin e saj përfundimtar u shpreh :-Për rrëzimin e padisë; si e analizoi çështjen ne teresine e saj :

V Ë R E N:

Paditësi i është drejtuar gjykatës me anën e padisë së mësipërme duke kërkuar sipas objektit të padisë.

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, gjykata mori ne shqyrtim dhe analizoi fillimisht juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje.

Ne lidhje me kete fakt gjykata ju referua ligjit me nr.49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative “KREUT III te saj (nenit 7,pika b) e saj)/kompetenca lëndore/ ne te cilin midis te tjerash citohet se :

Gjykatat administrative janë kompetente për : ”. *Gjykatat administrative janë kompetente për:a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;duke qene se ndodhemi perpara nje mosmarrveshje me karakter administrativ qe rrjedh nga marredheniet civile mes paleve ndergjyqese”, çmoi kryesisht se çështja e paraqitur është ne juridiksionin lendor te kesaj gjykate.*

Gjithashtu ne reference te nenit 10 te ligjit te mesipercituar”Kompetenca funksionale” ne te cilin citohet se :”1. Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normative,arriti ne kunkludimin se kjo çështje është nen kompetencen funksionale te kesaj gjykate.

Ne lidhje me competence tokesore kjo gjykate j’u referuar nejit 11 te ligjit me nr. 49/20012”Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” ne te cilin citohet se “1. *Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet. Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padija ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë.*

Gjithashtu Gjykata, në vështrim të neneve 12 te ligjit te mesipercituar, çmoi çështje duhet gjykuar me nje gjyqtar te vetëm.

Rrethanat e faktit.

Paditësja Elide Bombaj ka pasur një aktivitet privat“Parukeri” . Ketë aktivitet e ka regjistruar ne QKR dhe është pajisur me niptin përkatës. Ka aplikuar për kase fiskale dhe ne pritje te saj është pajisur me dëftesa tatimore.

Ne baze te Urdhrit te Punës me nr. 10577 Prot, date 07.09.2015, inspektoret e sektorit te Verifikimit ne Terren pranë DRT Vlore, kane ushtruar një kontroll ne ambientet e subjektit " Elide Bombaj " me Nipt L570052140.

Mbi bazën e kontrollit te ushtruar ne sheqerin "Elide Bombaj" është mbajtur Akt-Konstatimi me nr. serial 0215356 date 07.09.2015 ku rezultoi se:"...subjekti është i regjistruar ne QKR, subjekti nuk ka te instaluar pajisjen fiskale por ka aplikuar, lëshon dëftese tatimore, ne momentin e kontrollit nuk ka lëshuar asnjë dëftese tatimore, nuk ka te afishuar listën e çmimeve, ne momentin e kontrollit ne pune u gjeten një punonjës znj.Elide Bombaj e siguruar. Ora e kontrollit 12:50

Subjekti është penalizuar me gjobe në vlerën 35.000 leke, për këto penafitete subjekti është njoftuar me ane të aktit administrative njoftim vlerësimi nr. 15966 prot, date 18.12.2015. Akt konstatimi i mbajtur nga inspektoret është përcjell për procedura të mëtejshme në DRT Vlore, inspektori i dosjes ka bërë verifikimet e nevojshme dhe në bazë të konstatimit të mbajtur është mbajtur.

Proces-Verbal Gjobe me nr. serial, 0187531 date 13.12.2015, ku në bazë të Ligjit 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar) neni 130, subjekti është penalizuar me gjobe në masën 35.000 leke për mosafishim të listës së çmimeve të shitjes së mallrave apo shërbimeve.

Menjëherë ka bërë kërkesën për apelim të detyrimit tatimor dhe e ka dorëzuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlore në pritje të një përgjigje prej tyre.

Me pas nga Drejtoria e Mbledhjes së Borxhit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlore me është njoftuar me ane të shkresës nr 3772 date 18.03.2016 se nëse nuk paguaj vlerën e plote të gjobës, do të rrethohet mbledhja e detyrimit me forcë nga administrata tatimore.

Parashtrimet e palës paditëse;

Paditësja Elide Bombaj ka qenë duke hapur një aktivitet privat, (Parukeri) duke ndjekur të gjitha hapat që kërkon ligji për ta bërë të mundur këtë.

Ka regjistruar aktivitetin e saj në QKR dhe është pajisur me nipin përkatës. Ka aplikuar për kase fiskale dhe në pritje të saj është pajisur me dëftese tatimore.

Në datën 07.09.2015 është paraqitur pranë dyqanit inspektoret tatimore të cilët ushtruan kontrollin tatimor sipas ligjit.

Inspektoret i kanë thënë se nuk ka asnjë problem dhe se duhet të firmoste Akt-Konstatimin e tyre që ishte sipas tyre një procedure rutine. Por në aktin e përpiluar ata kanë konstatuar se paditësja nuk ka pasur të afishuar listën e çmimeve, si edhe që materialet që ndodheshin në parukeri u mungonin faturat tatimore të blerjes.

Pala paditëse pretendon se nuk është njoftuar se kishin konstatuar mangësi gjatë inspektimit, dhe se në mirëbesim të fjalës së tyre e ka firmosur këtë dokument.

Inspektoret nuk e kanë pyetur në lidhje me mangësitë që kishin konstatuar në këtë akt duke mos i dhënë mundësinë që të shpjegojë arsyen. Dy mangësitë që ata konstatuan janë mos afishimi i listës së çmimeve dhe mungesa e faturave të blerjes së mallit. Për këto dy mangësi paditësja pretendon se lista e çmimeve nuk ishte e afishuar nuk kam filluar ta ushtroj aktivitetin.

Përsa i përket faturave të mallrave që sipas tyre mungojnë nuk disponoj faturat e blerjes së tyre pasi ka kaluar kohë nga blerja e tyre dhe ato mund të kenë ngelur edhe në vendin ku jetojë jashtë shtetit.

Me pas pala paditëse i është njoftuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore me shkresën nr 15966 dt 18.12.2015 se kundrejt subjektit te saj rrendon një gjobe prej 35.000 leke te reja dhe se nëse kisha kundërshtime me këtë detyrim mund te beja një kërkesë për apelim.

Menjëherë ka bere kërkesën për apelim te detyrimit tatimor dhe e ka dorëzuar ne Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlore ne pritje te një përgjigje prej tyre.

Me pas nga Drejtoria e Mbledhjes se Borxhit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlore me është njoftuar me ane te shkresës nr 3772 date 18.03.2016 se nëse nuk paguan vlerën e plote te gjobës,do te zbatohet mbledhja e detyrimit me force nga administrate tatimore.

Prapësimet e palës se paditur:

Ne baze te Urdhrit te Punës me nr. 10577 Prot. date 07.09.2015, inspektorët e sektorit te Verifikimit ne Terren pranë DRT Vlore, kane ushtruar një kontroll ne ambientet e subjektit "ELIDE BOMBAJ" me Nipt L570052140. Nga pikëpamja ligjore kontrolli proceduralisht është i mbështetur ne Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH" i ndryshuar. Pra nga ana procedurale Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore legjitimohet plotësisht ne kontrollin e ushtruar ne subjektin "Elide Bombaj".

Mbi bazën e kontrollit te ushtruar ne sheqerin "Elide Bombaj" është mbajtur Akt-Konstatimi me nr. serial 0215356 date 07.09.2015 ku rezultoi se:

"...subjekti është i regjistruar ne QKR, subjekti nuk ka te instaluar pajisjen fiskale por ka aplikuar, lëshon dëftese tatimore, ne momentin e kontrollit nuk ka lëshuar asnjë dëftese tatimore, nuk ka te afishuar listën e çmimeve, ne momentin e kontrollit ne pune u gjeten një punonjës znj.Elide Bombaj e siguruar. Ora e kontrollit 12:⁵⁰

Subjekti është penalizuar me gjobe ne vlerën 35.000 leke, për këto penalitete subjekti është njoftuar me ane te aktit administrative njoftim vlerësimi nr. 15966 prot, date 18.12.2015. Akt konstatimi i mbajtur nga inspektorët është përcjell për procedura te mëtejshme ne DRT Vlore, inspektori i dosjes ka bere verifikimet e nevojshme dhe ne baze te konstatimit te mbajtur është mbajtur:

Sa mesiper, mund te themi se mosafishimi i listës se çmimeve te shitjes se mallrave apo shërbimeve, përben shkelje tatimore administrative dhe penalizohet me gjobe ne zbatim te nenit 130 te Ligjit 9920 dt.19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar), sipas te cilit citojmë: *"Mosafishimi i çmimeve te shitjes se mallrave apo shërbimeve dënohet me gjobe me 35 000 leke, për tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogël dhe 65 000 leke për tatimpaguesit e tjerë"*.

Sa mesiper, rezulton se kontrolli tatimor ka qene verifikim ne vend. Ne zbatim te Ligjit 9920 date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne RSH" i ndryshuar, nenit 80 Kontrolli tatimor dhe Udhëzimit ne zbatim te këtij ligji, pika 80.3 (c)

Pesa i takon aktit administrative Njoftim dhe kërkesë për pagesën e detyrimeve nr. 3772 prot, date 18.03.2016, e konsiderojmë të drejte dhe konform ligjit 9920 date 10.05.2008 "Për Procedurat Tatimore ne RSH" i ndryshuar, përkatësisht : Neni 89 "Njoftimi dhe kërkesa për të paguar" "1. Sa here që administrata tatimore konstaton se një tatimpagues nuk ka paguar plotësisht dhe në datën e caktuar detyrimet tatimore, administrata tatimore i dërgon, me poste rekomande, një njoftim me shkrim, ku kërkon pagesën e plote të detyrimit tatimor".

Bazuar në pikën 5, neni 108 të Ligjit 9920 date 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore ne RSH" i ndryshuar dhe pikën 108.5 të Udhëzimit në zbatim të tij, thuhet se: " Në procedurën e ankimit, barra e provës për të vërtetuar se një vlerësim tatimor apo vendim është i pasakte bie mbi tatimpaguesin".

Duke ju referuar të gjithave fakteve të mësipërme pala e paditur ka kërkuar rrezimin e kërkesë padisë dhe lënien në fuqi të aktit administrativ "Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore" nr. 15966 prot, date 18.12.2015 të DRT Vlorë, si akte të mbështetura plotësisht në ligj dhe konform të gjitha procedurave tatimore.

Zgjidhja ligjore

Gjykata në lidhje me barrën e provës , ka për reference nenin 35 të ligjit me nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"-Barra e provës në të cilin citohet se : "1. Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë.

Duke vlerësuar në tërësi rrethanat faktike të provuara në gjykim nëpërmjet provave shkresore, thëniet dhe pohimet e palëve ndërgjyqës, të çmuara në përputhje me nenet 10,11,12, 29, 213, 214, 246 e vijues dhe 253 e vijues të KPrC dhe mbështetjen ligjore të padisë, si dhe duke referuar në hapësirën ligjore që krijon neni 16 i KPrC sipas të cilit "Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimet që mund të propozojnë palët.", arrin në konkluzionin se padia duhet rrezuar për arsyet si më poshtë vijon:

Në baze të Urdhrit të Punës me nr. 10577 Prot, date 07.09.2015, inspektoret e sektorit të Verifikimit në Terren pranë DRT Vlore, kanë ushtruar një kontroll në ambientet e subjektit "ELIDE BOMBAJ" me Nipt L570052140. Nga pikëpamja ligjore kontrolli proceduralisht është i mbështetur në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore ne RSH" i ndryshuar. Pra nga ana procedurale Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore legjitimohet plotësisht në kontrollin e ushtruar në subjektin "Elide Bombaj".

Mbi bazën e kontrollit të ushtruar në sheqerin "Elide Bombaj" është mbajtur Akt-Konstatimi me nr. serial 0215356 date 07.09.2015 ku rezultoi se: "...subjekti është i regjistruar në QKR, subjekti nuk ka të instaluar pajisjen fiskale por ka aplikuar, lëshon deftese tatimore, në momentin e kontrollit nuk ka lëshuar asnjë deftese tatimore, nuk ka të afishuar listën e çmimeve, në momentin e kontrollit në punë u gjeten një punonjës znj. Elide Bombaj e siguruar. Ora e kontrollit 12.⁵⁰

Subjekti është penalizuar me gjobe në vlerën 35.000 leke, për këto penalitete subjekti është njoftuar me anë të aktit administrativ njoftim vleresimi nr. 15966 prot, date 18.12.2015. Akt konstatimi i mbajtur nga inspektorët është përcjell për procedura të mëtejshme në DRT Vlorë, inspektori i dosjes ka bërë verifikimet e nevojshme dhe në bazë të konstatimit të mbajtur është mbajtur:

Proces-Verbal Gjore me nr. serial, 0187531 date 13.12.2015, ku në bazë të Ligjit 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) neni 130, subjekti është penalizuar me gjobe në masën 35.000 leke për mosafishim të listës së çmimeve të shitjes së mallrave apo shërbimeve.

Megjithatë në një situatë të mungesës së kases fiskale ligji e ka të përcaktuar qatë se duhet të zëvendësohet për efekt të provueshmërisë së shërbimit kundrejt klientit me deftese tatimore e cila terhiqet pranë D.R. Tatimeve. Mungesa e saj konsiderohet njëloj sikurse në mungesë të kases fiskale.

Sipas Udhezimit nr. 16. dt. 03.05.2010, "Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale", pika 19. Përdorimi i deftesave tatimore në rastet e mosfunksionimit të perkohshëm të pajisjeve fiskale, përcaktohet se: "Në rastet e mosfunksionimit të perkohshëm të pajisjeve fiskale, të parashikuara në vendimin e Keshillit të Ministrave, tatimpaguesit janë të detyruar të përdorin deftesën tatimore për çdo shitje me pakicë që realizojnë. Blloku me deftesa tatimore do të furnizohet nga drejtorite rajonale tatimore dhe do të jetë me nr. serial (modeli bashkangjitur udhezimit)".

Nga sa më sipër lidhur me detyrimin për të instaluar dhe përdorur pajisjet fiskale, referuar Ligjit 9920 date 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore", neni 55 "Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale", thekson: 1. Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, janë të detyruar të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal, nepermjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor, si dhe Vendimi i Keshillit të Ministrave nr. 781, dt. 14.11.2007 pika 1 thuhet: "Te gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise, apo njësi të përhershme të hapura për publikun, instalojnë pajisje fiskale dhe lëshojnë kupone tatimor për çdo transaksion".

Pala e paditur ka pretenduar se administrata tatimore ka ndjekur të gjithë procedurën që parashkon Ligji 9920/2009 "Për Procedurat Tatimore". Inspektorët kanë ushtruar kontroll pranë shoqërisë paditëse dhe aty kanë konstatuar se kjo shoqëri ka realizuar shitje pa lëshuar kuponin tatimor.

Neni 122 Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave

1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:

- a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit:
- b) nuk lëshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve:
- i) për çdo konstatim (verifikim) të kryer, me gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë;

Mos afishimi i listës së çmimeve të shitjes së mallrave apo shërbimeve, përben shkelje tatimore administrative dhe penalizohet me gjobe në zbatim të nenit 130 të Ligjit 9920 dt.19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar), sipas të cilit citojmë: "Mosafishimi i çmimeve të shitjes së mallrave apo shërbimeve dënohet me gjobe me 35 000 leke, për tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogël dhe 65 000 leke për tatimpaguesit e tjerë". Bazuar dhe në nenin 59 të Ligjit 9920 dt.19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar), pika 2. "...tatimpaguesi, në përputhje me legjislacionin tatimor, duhet të reklamojë në vende të dukshme, çmimet e mallrave dhe të shërbimeve që ofron".

Si dhe në Udhëzimin MF, dale në zbatim të ke të ligji përkatësisht pika 59.2 Afishimi i çmimeve 59.2.7 "Personat e tatueshëm që shesin mallra apo shërbime me pakice janë të detyruar të afishojnë në mënyrë të dukshme me etikete, çmimin e çdo malli apo shërbimi që ata ofrojnë".

Sa me sipër, rezultojnë se kontrolli tatimor ka qenë verifikim në vend. Në zbatim të Ligjit 9920 date 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar, neni 80 Kontrolli tatimor dhe Udhëzimit në zbatim të këtij ligji, pika 80.3 (c) është përcaktuar se: "Këto verifikime të shkurtra synojnë zbulimin në kohë të shkeljeve që kanë lidhje me regjistrimin e personave të tatueshëm (identifikimin e personave të përgjaturuar), me përdorimin e pajisjeve fiskale, me përdorimin e pullave fiskale në mallrat e akcizës, me dokumentimin e mallrave në ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin e faturave tatimore, etj.

Këto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak të personave të tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit në momentin e verifikimit, të dokumentit personal të verifikuesit dhe urdhrin e ditës, të lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë së kontrollit për verifikime në vend". Kontrolli është ushtruar në baze të Urdhrit të Punës me nr. 10577 Prot, date 07.09.2015 dhe Akt-Konstatimi me nr. serial 0215356 date 07.09.2015 i cili është firmosur nga vete Znj. Elide Bmombaj e cila me nënshkrimin e saj ka pranuar çdo gjë të shkruar mbi Akt Konstatimin.

Pesa i takon aktit administrative "Njoftim dhe kërkesë për pagesën e detyrimeve" nr. 3772 prot, date 18.03.2016, e konsiderojmë të drejte dhe konforme ligjit 9920 date 10.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar, përkatësisht : Neni 89 "Njoftimi dhe kërkesa për të paguar" "1. Sa herë që administrata tatimore konstaton se një tatimpagues nuk ka paguar plotësisht dhe në datën e caktuar detyrimet tatimore, administrata tatimore i dërgon, me postë rekomandë, një njoftim me shkrim, ku kërkon pagesën e plote të detyrimit tatimor". Udhëzimi në zbatim të ke të ligji 89.1 "Duke pasur parasysh përmbushjen e dispozitave të pikës 88 me lart, kur administrata tatimore, arrin në përfundimin se një detyrim tatimor nuk është paguar plotësisht, ajo menjëherë njofton tatimpaguesin për detyrimin e papaguar, nëpërmjet postës rekomandë".

88. Autoriteti dhe kompetencat për mbledhjen e detyrimit tatimor 88.1.1 "Sipas nenit 88 te ligji paragrafi I, administrata tatimore ka autoritetin për te mbledhur me force detyrimet tatimore te papaguara, kur konstaton se tatimpaguesi nuk ka paguar ne afat detyrimet e tij tatimore. Para se te filloje procedurat e mbledhjes me force te detyrimeve tatimore, administrata tatimore ka per detyre te verifikojë nëse personi ndaj te cilit ajo do te veproje sipas parashikimeve te Kreut XI te ligjit për procedurat tatimore, ka apeluar detyrimin tatimor ne hallkën përkatëse te apelimit tatimor, konform kërkesave te këtij ligji. Ne rastet kur detyrimi tatimor nuk është apeluar ose është humbur e drejta e apelimit ose ekziston një vendim apelimi i formës se prere, administrata tatimore është e detyruar te dërgoje ne adrese te tatim paguesit njoftimin per pagimin e detyrimeve tatimore, dhe te njoftoje atë për fillimin e procedurave te mbledhjes me force te detyrimeve tatimore".

Bazuar ne piken 5, neni 108 te Ligjit 9920 date 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore ne RSH" i ndryshuar dhe piken 108.5 te Udhëzimit ne zbatim te tij, thuhet se: " Ne procedurën e ankimit, barra e provës për te vërtetuar se një vlerësim tatimor apo vendim është i pasakte bie mbi tatimpaguesin".

Prej palës se paditur administrata tatimore është ndjekur e gjithë procedurën që parashikon Ligji 9920/2009 "Per Procedurat Tatimore".

Gjykata çmon se aktet administrative objekt gjykimi nuk vijnë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligj duke i bërë këto në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative si dhe të Ligjit për Kundravajtjet Administrative. Gjykata nuk gjen shkak ligjor për shfuqizimin e këtyre akteve administrative te palës se paditur.

Sa me siper, gjykata krijoi bindjen se kërkesa padia subjekti Elide Bombaj është e pa mbështetur në ligj dhe ne prova dhe, si rrjedhojë ajo duhet rrezuar.

Vlen te theksohet se ku vendim ne mbeshtetje te nenit 45 te ligjit nr.49/2012 « Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative » nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

...
b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

Rezulton se ne rastin konkret masa e denimit administrativ kundrejt paditeit ka qene ne masen 35.000 leke dhe per rrjedhohe ndaj ketij vendimi nuk mund te kryhet ankim

PER KETO ARSYE :

Gjykata, bazuar ne nenin 126 dhe 310 te K.Pr.Civile dhe nenet 40, 42 te ligjit me nr.49/2012 nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative" :

V E N D O S I:

- Rrezimin e padisë.
- Shpenzimet gjyqësore palës paditëse.

- Ky vendim ne reference te nenit 45/ç te ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" është i formës se prere.

U Shpall,ne Vlore sot me date 16.05.2016

SEKRETARE

Anil Rista



GJYQTARI

Astrit Shema



SHPENEZIMET GJYQESORE

Takse padie 3000 leke

Takse njoftimi 200 lek

Takse avokatie leke

Shuma totale 32000 leke

